

A dëshiron të punosh në mënyrë kreative dhe me duart e tua?

A dëshiron të nisësh sipërmarrjen tënde në ardhmëri?

A dëshiron të provosh të punosh që nga koha e gjimnazit?

A dëshiron të keshë një kualifikim që është teorik por poashtu edhe praktik?

A dëshiron të vazhdosh të ndërtosh një traditë të vjetër artizanati?

Në atë rast, Programi i artizanatit mund të jetë për ty.

Te Programi i artizanatit do të jepet mundësi të mësosh për shërbime, përgjegjësi, ekonomi, marketing dhe komunikim. Të gjitha këto të nevojiten nëse dëshiron të punosh me artizanat në ardhmëri. Por në rast se zgjedh Programin e artizanatit, ndoshta tashmë e ke një interesim të posaçëm të cilin do që ta zhvillosh dhe të bëhesh vërtetë i aftësuar në atë lëmi. Te programi do të zhvillosh artizanatin tënd dhe ndjenjën për ngjyra dhe forma.

### **Të punosh apo t'i vazhdosh studimet**

Nëse zgjedh Programin e artizanatit mund të kërkoesh punë menjëherë pas gjimnazit. Llojet e punëve ku mund të pranohesh varren nga drejtimi që e ke zgjedhur, cilat kurse i ke ndjekur, si duket tregu për pikërisht artizanatin tënd dhe sa i aftë je në atë që e bën. Në disa raste të jepet mundësia që të fillimisht të punosh si çirak gjatë një viti apo gjatë disa viteve. Në atë rast do të marrësh rrogë çiraku dhe do të jepet mundësia të punosh së bashku me persona që janë të punësuar në lëminë tënde me qëllim që të mësosh prej tyre. Ato kanë dituri të posaçme dhe kanë përvojë pune të gjatë.

Që të keshë një mundësi inkuadrimi për pikërisht punën e artizanatit që të intereson ty, ndoshta do të duhet të vazhdosh studimet pas gjimnazit. Mund të zgjedhësh një kualifikim tek Fakulteti i profesioneve ose një kualifikim në fakultet. Ekzistojnë shumë skolla speciale të popullarizuara dhe kualifikime speciale që mund të jenë të vështira të pranohesh.

### **Punë ku mund të pranohesh**

Shembull të punëve të artizanatit janë ndërtues anijesh, floktar, florist, formues qelqi, desinjator mode, zdruckhtar mobiljesh, rrobaqepës dhe orëndreqës.

## **Përmbajtja e Programit**

Programi i artizanatit përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurset e tjera janë të veçanta për Programmin e artizanatit. Disa nga kurset do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi i artizanatit nuk ka drejtime kombëtare. Kjo do të thotë se të gjitha shkollat kanë mundësi që të formojnë drejtimet e veta. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve se ku mund të studijosh artizanatin që të intereson ty.

## **Kontakte me tregun e punës**

Te Programi i artizanatit do të kesh kontakte me tregun e punë që nga koha e gjimnazit. Do të keshë të paktën 15 javë kualifikim në vende të punës (APU). Te vendi i punës do të mësosh se si mund të punosh me artizanatin që e ke zgjedhur, për çka duhet të kesh dijeni të mira dhe për gjëra tjera të cilat mund të jenë të vështira që të mësohen në shkollë. APU është një mënyrë e mirë për krijime kontaktesh të cilat mund t'i përdorësh kur do të kërkosh punë. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, kjo mundësi do t'ju jepet.

## **Ardhmëri dhe punë**

Është e vështirë të themi se në rast se do të bëhet lehtë apo vështirë për ty që të punësoshesh pasi që i ke përfunduar studimet te Programi i artizanatit. Në radhë të parë kjo varret nga lloji i artizanatit që e ke zgjedhur. Duhet të jeshë në gjendje të shpërngulesh apo të udhëtosh që të punësoshesh. Ndoshta do ta nisësh sipërmarrjen tënde pas gjimnazit. Ndoshta ka ndonjë shoqatë apo organizatë antërarët e të cialve mund të bashkohen me ty. Pyeti ato se i duket tregu i punës.